



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....<sup>9</sup> Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më 17/01 / 2022

**VENDIM**

Nr.01, date 17/01/2022

**PËR**

**PROBLEMATIKAT NE DIGEN E HEC MOGLICES**

Në mbështetje te Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) ne mbledhjen e dates 17.01.2022 mori ne shqyrtim Vleresimin e Statusit pas ndertimit te Diges se HEC Moglices te preqatitur nga Konsulenti AFRY dhe paraqitur nga Kompania "DEVOLLI HYDROPOWER" shpk ne lidhje me problematikat e evidentuara ne digen e HEC Moglices si dhe monitorimin e kesaj situate gjate kesaj kohe dhe ne te ardhmen. Bazuar ne dokumentacionin teknik te paraqitur, informacionin e derisotem ne lidhje me uljet ne digen e HEC Moglices si dhe Rezultateve te monitorimit te diges, **KKDM arrin ne perfundim se Diga e HEC Moglices aktualisht eshte ne nivelin 2 te Alarmit i cili kerkon planifikimin e punimeve lehtesuese/korrigjuese ne dige si dhe nje monitorim te vazhdueshem dhe te vecante te te gjithe elementeve te diges.** Per sa me siper, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Ti kërkojë Kompanise DEVOLLI HYDROPOWER shpk
  - **Dorezimin prane KKDM te projektit te ndertimit sipas faktit** per digen e HEC Moglice brenda muajit Mars 2022. Ky projekt duhet te perfshije jo vetem vizatimet teknike sipas faktit te shtresave apo te punimeve te betonit por edhe rezultatet e testeve laboratorike te materialeve te perdonura si dhe te gjitha dokumentat teknike te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi;
  - **Riparimin dhe rivenien ne pune, brenda muajit Mars 2022, te Inklinometrit MOG-IN-250** I cili qe prej tetorit 2020 eshte jasht pune;
  - **Marrjen e masave per matjet dhe monitorimin e te gjitha filtrimeve ne dige** duke perfshire edhe filtrimet qe dalin ne galerine e Kontrollit tek pika STA 195 brenda muajit Mars 2022. Keto matje duhet te jene pjesa e bazes se te dhenave te filtrimeve ne te gjithe zonen e diges dhe te jene pjesa e analizes se filtrimeve ne digen e HEC Moglice;
  - **Te kryeje monitorimin e presioneve te piezometrave** nen pllakat e kaperderdhesit gjate funksionimit te sistemit te shkarkimit
  - **Te kryeje vrojtimin dhe Monitorimin e uljes diferenciale** ne vendin e bashkimit midis sistemit te shkarkimit dhe diges
  - **Kryerjen e Kalibrimit te pajisjeve te Monitorimit** qe jane evidentuar me te dhena te gabuara brenda muajit Mars 2022;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

- **Kryerjen e nje Analize dhe krahasimin e vlerave te matjeve gjate Monitorimit Gjeodezik, Monitorimit te uljeve te dhena ne Inklinometra si dhe Monitorimit te filtrimeve te matura duke bere edhe nje vleresim te thelluar te ketyre monitorimeve ne lidhje me uljet apo levizjet e konstatuara deri me sot;**
- **Kryerjen e nje Analize dhe Vleresimi te hollesishem dhe te thelluar te qendrueshmerise se trupit te diges/ Stabilitetit statik dhe dinamik te diges duke u bazuar ne gjeometrine aktuale te diges si dhe te te dhenave faktike te testeve labororatike per treguesit kryesore te materialeve mbushes te hedhur faktikisht ne objekt; Gjate ketj Vleresimi duhet te behet nje krahasi i qarte i rezultateve te llogaritjeve per qendrueshmerine e diges te bazuara ne te dhenat e vlerave te rekomanduara te paraqitura ne Tabellen 4.3 te raportit kryesor me te dhenat e marra nga testet laboratorike te vitit 2016 si dhe rezultatet e investigimeve ne terren gjate vitit 202. Ne perfundim te ketij Vleresimi duhet te jepen perfundime te qarta dhe te plota ne lidhje me qendrueshmerine e diges dhe per masat e tjera shtese perforcuese/korriguese te metejshme per te rritur sigurine e diges. Kjo kerkese lidhet edhe me faktin e konstatimit nga Konsulenti i Shfrytezuesit te diges se uljet e konstatuara korrespondojne me nivelin 2 te Alarmit i cili kerkon planifikimin e punimeve lethesuese/korriguese ne dige.**
- **Vazhdimin e monitorimit te diges dhe uljeve te saj ne vazhdimesi sipas udhezimeve dhe rekomandimeve te dhena nga KKDM gjate kesaj periudhe. Ne rast te evidentimit te ngjarjeve jo te zakonta, Shfrytezuesi I diges duhet te njoftoje menjehere KKDM dhe institucionet perkatese per ngjarjet e ndodhura dhe zgjidhjen e problemeve qe mund te hasen;**
- **Hartimin e nje Raporti Teknik te shoqeruar me analizat dhe Vleresimet e kerkuar me siper, me te dhenat e monitorimit deri ne Mars 2022, konkluzionet perkatese te grupit te eksperteve ne lidhje me qendrueshmerine dhe sigurine e diges ne te ardhmen, masat qe parashikon shfrytezuesi i diges ne te ardhmen ne lidhje me monitorimin, mirembajtjen dhe sigurine e diges se HEC Moglice. Raporti duhet te dorezohet prane KKDM brenda muajit Korrik 2022.**

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM per ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjisacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

